# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-458328**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Tirana mbledh drejtues të sigurisë nga SHBA-ja dhe Europa, në fokus krimi, dronët dhe pasuritë e sekuestruara |
| ADRESA | `https://albeu.com/lajme/tirana-mbledh-drejtues-te-sigurise-nga-shba-ja-dhe-europa-ne-fokus-krimi-dronet-dhe-pasurite-e-sekuestruara/1019014/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 16:50:36 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 16:47:25 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `ca6167115ff8176f60ae776437cc17a39cdbe6647e8d235a3592879de2750fb0` |
| TEKSTI | `5ed767c89d6a40a66d90ce59a6a4d7b73ad53dcbe5a6ff990b5077188f8af7ca` |
| PAMJA | `325d855205f1c39d2ab43daf54d4560cf8e200f1e6b618ef5f88947df486c7ab` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `6f6aabf45e97670781806dddbe74cb76816a7080532a6a248209cdf3c1168c83` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `54ed48543a6253cb20faf0026ba4de200ea88d62566e99edbe4b1e5f6894ea0c` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/6f6aabf45e97670781806dddbe74cb76816a7080532a6a248209cdf3c1168c83`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Tirana mbledh drejtues të sigurisë nga SHBA-ja dhe Europa, në fokus krimi, dronët dhe pasuritë e sekuestruara




Nga 19 deri më 23 shtator, Tirana është mikpritëse e takimit të 42-të të kapitullit europian të FBI National Academy Associates (FBINAA), ku janë mbledhur drejtues dhe specialistë të sigurisë nga SHBA-ja dhe Europa.

Axhenda e siguruar nga Euronews Albania përmban një gamë të gjerë çështjesh që lidhen me sigurinë dhe goditjen e kriminalitetit. Mes tyre janë krimi i organizuar, terrorizmi, ekstremizmi në internet, grupi "764", përdorimi i dronëve, krimi kibernetik, gjurmimi i parave të krimit, sekuestrimi i pasurive, narkotikët dhe ekstradimet.

Në këtë aktivitet janë përfshirë përfaqësues të institucioneve nga Shqipëria dhe SHBA-ja. Programi parashikon praninë e drejtuesve të Policisë së Shtetit, SPAK-ut, BKH-së dhe Prokurorisë. Pala amerikane përfaqësohet edhe nga Spencer Horn, Zëvendës Ndihmës Drejtor në FBI, si dhe nga Brendan Collins, atasheu i FBI-së në Sofje.

Lufta kundër krimit të organizuar

Punimet hapen me trajtimin e masave kundër krimit të organizuar dhe me përvojën e Budapest Organized Crime Task Force, e cila shënon 25 vjet bashkëpunim.

Pjesë e diskutimeve është gjithashtu modeli amerikan Joint Terrorism Task Force, përmes të cilit disa agjenci bashkojnë kapacitetet për hetimin e kërcënimeve terroriste.

Përfaqësuesit shqiptarë do të trajtojnë ndërkohë problematikat që lidhen me krimet ndërkufitare dhe migracionin e paligjshëm.

Grupimi online "764"

të fundit/


Kapiteni Visar Shala përfundon me sukses Akademinë Kombëtar…


Dinamo dhe Laçi përballen në "Elbasan Arena", nis dueli dire…


Pogradeci tërheq gjithnjë e më shumë turistë të huaj, mbi 50…


Skënderbeu shmang humbjen në fund, Ahmataj: Terreni ndik…


Deklarata për ish-deputetin e Agimit të Artë ndez debat në…


Tensionet në Detin e Kuq, Greqia dhe Italia kërkojnë shtimin e…


Çitaku kërkon që aktgjykimi ndaj ish-drejtuesve të UÇK-së…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Vëmendje e veçantë i kushtohet grupit "764", të cilin autoritetet amerikane e lidhin me veprimtari kriminale në internet dhe me forma të ekstremizmit të dhunshëm.

Një zyrtar i FBI-së nga Berlini do të mbajë prezantimin me temë "Nihilistic Violent Extremism and 764". Më pas, pjesëmarrësit do të shqyrtojnë format e reja të ekstremizmit të dhunshëm dhe eksperiencën e Shqipërisë në përballjen me to.

Ekspertiza e FBI-së për dronët

Konferenca përfshin edhe një sesion të dedikuar për dronët. Specialistë të FBI Laboratory Division do të paraqesin teknologjitë e përdorura gjatë ekzaminimit dhe analizimit të tyre.

Pas këtij prezantimi, fokusi zhvendoset te krimi kibernetik dhe te koordinimi ndërkombëtar për luftimin e grupeve kriminale.

Gjurmimi i parave të krimit

Ndjekja e të ardhurave të siguruara nga veprimtaritë kriminale përbën një tjetër çështje kryesore të takimit. Në këtë kuadër do të analizohet roli që ka inteligjenca financiare në luftën kundër krimit të organizuar.

Në axhendë figuron edhe tema "From Confiscation to Public Good", e cila trajton mënyrat se si pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara mund të vihen në shërbim të qëllimeve publike.

BKH prezanton një hetim për narkotikët

Një rast konkret në fushën e narkotikëve, i hetuar nga Byroja Kombëtare e Hetimit, është përfshirë gjithashtu në program. Çështja do të paraqitet nga Eduart Kaloshi, hetues pranë BKH-së.

Krahas diskutimeve teorike, pjesëmarrësit do të ndajnë kështu edhe përvojat e krijuara gjatë hetimeve konkrete.

Procedurat e ekstradimit

Dita përmbyllëse do të përqendrohet te ekstradimet dhe bashkëpunimi ndërkombëtar. Diskutimet do të trajtojnë procedurat që zbaton Shqipëria, vështirësitë e hasura në praktikë dhe format e bashkëpunimit me shtetet e tjera.

Shtuar më 19.09.2026 18:47

Tags: aktualitet , fbi , Lajm kryesor , SPAK , Tiranë , vendi


Pogradeci tërheq gjithnjë e më shumë turistë të huaj, mbi 500 mijë vizitorë deri…


Deklarata për ish-deputetin e Agimit të Artë ndez debat në Greqi, Fredi Beleri…


Vila luksoze në Palasë që dyshohet se i përket Belinda Ballukut, Klodian…


Përplasje në Kuvend, Tedi Blushi-Ramës: Halli i shqiptarëve janë 16…


Bardhi për Ballukun: Mungesa në Kuvend dëshmon tensionet me…


Harta e re territoriale pritet të miratohet më 8 tetor, mazhoranca pro dhe PD…


Kërliçi kritikon Ramën për 12 ditë pa reagim ndaj përgjimeve të Ahmetajt:…


Dënimi i 4 ish-krerëve të UÇK-së, Erion Veliaj: Do t'i propozoj Këshillit Bashki…

albeu që nga viti 2003 © 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko... Kërko



| Kryesore | Kategori | Linqet | Tags | Moti |
|---|---|---|---|---|
| Erion Veliaj | Lifestyle | Live tv shqiptare | Edi Rama | Moti në Tiranë |
| Free Esim | Showbiz | Moti në Shqipëri | Albania News | Moti në Prishtinë |
| Zgjedhjet 2025 | Tech | Travel | Ilir Meta | Moti në Shkup |
| Belinda Balluku | Shëndetësi | Horoskopi | Piranjat | Moti në Durrës |
| SPAK | Argetim | Livescore | gazeta, tv, portale | Moti në Prizren |
| Kombëtarja | Enciklopedi | News from Albania | Sali Berisha | Moti në Tetovë |

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com |

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.